



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:142079  
Datë: 29.03.2024  
Numri i dokumentit: 05522655

Ac.nr.1661/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në bulevardin “Bill Klinton”, nr.5, ndërtesa Elektrokosova, Kati VII në Prishtinë, kundër debitorit F. (I.) S., me vendbanim në rr. “W. Sh.” nr.1 në Prishtinë, për përmbarimin e kërkesës në të holla, pagesën e borxhit në shumë prej 5,830.43 €, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.717/2022, të datës 12.06.2023, me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PJESËRISHT aprovohet e themeltë ankesa e debitorit F. (I.) S., nga Prishtina, NDRYSHOHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.717/2022, të datës 12.06.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit F. (I.) S. nga Prishtina, SHFUQIZOHET (vihet jashtë fuqie) pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.405/22, i datës 23.06.2022, për periudhën nga data 23.08.2019 deri me datën 01.06.2021, në shumë prej 5,172.05 Euro, ashtu që propozimi për përmbarim i kreditorit për këtë shumë të borxhit REFUZOHET I PABAZUAR.

MBETET në fuqi pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.405/22, i datës 23.06.2022, për periudhën nga data 01.06.2021 deri me datë 22.06.2022 në shumë prej 657.93 Euro.

\

## A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, është vendosur si në vijim REFUZOHET i pabazuar, prapësimi i debitorit F. (I.) S. nga Prishtina i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.405/22 të dt.21.07.2020, të lejuar nga Zyra Përmbarrimore e Përmbarruesit privat Ilir Mulhaxha me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, debitori brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarrimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës ankesën e debitorit ta aprovojë si të bazuar ndërsa urdhrin përmbarrimor ta anulojë.

Nuk është parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), ka gjetur se:

*Ankesa e debitorit, është pjesërisht e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori, më datë 22.06.2022, përmes përmbarruesit privat, ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga librat afariste, për pagesën e borxhit në emër të energjisë elektrike të shpenzuar nga debitori, për periudhën kohore nga data 23.08.2019 deri më datë 06.05.2022, në shumë totale prej 5,830.43 €, me kamatë 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë, me detaje tjera si në propozimin për përmbarrim. Përmbarruesi privat Ilir Z. Mulhaxha, me Urdhrin P.nr.405/22, të datës 23.06.2022, ka lejuar përmbarrimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori ndaj këtij urdhri, me datë 04.07.2022 ka parashtruar prapësim duke i kundërshtuar pretendimet si në propozimin për përmbarrim si të pa bazuara me arsyetimin se dokumenti në bazë të cili është lëshuar urdhri përmbarrues nuk ka tipare për përmbarrueshmëri dhe ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përmbarrimi, me propozim që prapësimi i të njëjtit të aprovohet si i bazuar ndërsa urdhri përmbarrimor P.nr.405/22, i datës 23.06.2022 të anulohet e po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet në emër të përpilimit për prapësim.

Kreditore ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit me theksimet se fillimisht pretendimet e debitorit se propozimi për përmbarrim është iniciuar mbi dokument i cili nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë nuk qëndrojnë pasi që kreditore ka bërë propozimin për përmbarrim në bazë të dispozitave ligjore të përcaktuara me LPP dhe ka iniciuar propozim për përmbarrim me anë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga

librat afariste e një gjë e tillë përcaktohet me nenin 29 të LPP-së. Po ashtu debitori ka bërë pagesa vullnetare dhe të njëjtat janë të mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit konform nenit 368 të LMD-së. Ka propozuar që gjykata kompetente të caktojë seancë publike në të cilën do të qartësohet vlefshmëria dhe domethënia e përgjigjes së kreditorit.

Gjykata e shkallë së parë duke vendosur sipas prapësimit të debitorit ka nxjerr aktvendimin e atakuar PPP.nr.717/2022, i datës 12.06.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor e ka lënë në fuqi. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se gjykata vlerëson se në këtë çështje përmbarimore, dokumentet e besueshme – ekstrakti i lëshuar nga kreditori, përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit ngase janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 27 i LPP për të qenë të pambarueshme dhe njëkohësisht të përshtatshme për përmbarim dhe se nga ekstrakti si pjesë e shkresave të lëndës rezulton se debitori me dt.04.04.2022, në emër të shpenzimeve të energjisë elektrike ka paguar vlerën prej 50.00€, me ç ‘rast ka ndërprerë periudhën e parashkrimit dhe në këtë kontekst gjykata vlerëson se kërkesa e kreditorit nuk është e parashkruar.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 27 dhe 73 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, e në veçanti nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën e nenit 368 paragrafi 1 të LMD-së, që e rregullojnë institutin e parashkrimit, të cilin pala debitore e ka ngritur në prapësimin e tij.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike me rastin e marrjes së aktvendimit të atakuar, por në mënyrë të gabuar e ka bërë zbatimin e të drejtës materiale, për çka edhe u dashtë që aktvendimi i atakuar të ndryshohet. Në këtë kontekst Gjykata e Apelit vlerëson se me dispozitën e nenit 360 paragrafi 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*.

Me nenin 368 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*.

Me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: “*Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*”. Me nenin 373 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “*Pas ndërprerjes së parashkrimit fillon të rrjedh përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim*”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: “*Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedh përsëri nga pranimi (pohimi)*”.

Nga interpretimi dhe kuptimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për çka edhe ka vendosur që të njëjtin ta ndryshojë, duke e shfuqizuar pjesërisht urdhrin për lejimin e përmbarimit P.405/22, të datës 23.06.2022 dhe atë për periudhën nga data 23.08.2019 deri me datën 01.06.2021, në shumë prej 5,175,05 €, ndërsa pagesat brenda kësaj periudhe përfshin totalin e borxhit të mbetur në shumën 5,830.43 Euro), ndërsa propozimin për përmbarim ta refuzojë si të pabazuar, pasi që borxhi për këtë periudhë është parashkruar në kuptim të dispozitave të lartcituara, prandaj referuar paragrafit 2 të nenit 360, në rastin konkret për kërkesën e kreditorit që ka të bëjë me periudhën kohore prej 23.08.2019, afati i parashkrimit të borxhit ka filluar të rrjedhë menjëherë pas skadimit të afatit për pagesën e borxhit e që nënkupton se borxhi i kërkuar nga kreditori nga data 23.08.2019 deri më 01.06.2021 është parashkruar në kuptim të nenit 360 par. 1 të LMD-së pasi që për këtë periudhë kohore nuk kishte ndërprerje të parashkrimit të kërkesës sepse propozimi për përmbarim është ushtruar me datën 22.06.2022 dhe pagesat e bëra në mënyrë paushallë nuk e ndërprejnë parashkrimin sepse këto pagesa nuk janë të qarta dhe nuk dihet se cili borxh është paguar. Andaj, në rastin konkret gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të zbatoj dispozitën e nenit 386.2 të LMD-së, pasi që pagesat e borxhit në këtë mënyrë siç janë paguar nga debitori nuk paraqesin kështu për tu konsideruar se është ndërprer parashkrimin, por të njëjtat janë pagesë paushallë borxhit. Andaj, gjykata e Apelit vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi pasi që për këtë periudhë të borxhit ka kaluar afati 1-vjeçar i parashkrimit të kërkesës së kreditorit.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket mënyrës së vendosjes lidhur me pjesën refuzuese që i referohet mbetjes në fuqi të përsëritshëm të urdhrit përmbarimor P.nr.405/22, i datës 23.06.2022, për periudhën nga data 01.06.2021 deri me datë 22.06.2022, për shumën prej 657,93 Euro, Gjykata e Apelit një mënyrë të tillë të vendosjes e ka bazuar në dispozitën e nenit 360 paragrafi 2, 368 paragrafi 1 dhe 369 të LMD-së, pasi që në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës së kreditorit për faktin se me paraqitjen e propozimit për përmbarim të kreditorit me datë 22.06.2022, është ndërprerë afati i parashkrimit, për periudhën 01.06.2021 deri me datën 22.06.2022, konkretisht për shumën prej 657,93 € dhe rrjedhimisht edhe debitori është i obliguar që të përmbushë detyrimin e tij në këtë shumë.

Nga këto arsye, marrë për bazë pretendimin ankimor të palës ankuese rreth zbatimit të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit, gjen se në rastin konkret kemi parashkrim të pjesërishtëm të borxhit, andaj edhe për këtë arsyeja ka vendosur që aktvendimin e ankimuar të ndryshojë, të shfuqizohet pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit sa i përket shumës prej 5.172.05 Euro për periudhën

nga data 23.08.2019 deri me datën 06.05.2022 dhe të refuzohet propozimi për përmbarim për këtë shumë, pasi që kërkesa është e parashkruar, ndërsa sa i përket borxhit për periudhën 01.06.2021 deri me datën 22.06.2022 në shumë prej 657,93 Euro, një kërkesë e tillë nuk është parashkruar, pasi që me paraqitjen e propozimit për përmbarim me datë 22.06.2022, është ndërprerë afati i parashkrimit, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, që secila palë të bartë shpenzimet e saj të procedurës duke u bazuar në dispozitën e nenit 452.2 të LPK-së, pasi që e ka pasur parasysh suksesin e palëve në procedurën përmbarimore

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbarimore ” *në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika c) të LPK, lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.A.P.nr.1661/2023, më datë 27.03.2024.

Gjyqtari,  
Besnik Bislimaj, d.v